




**UDHËZUES PËR  
FUNKSIONIMIN E  
RRJETEVE PROFESIONALE  
TË MËSUESVE NDIHMËS  
PRANË ÇDO ZVA-je**



Informacioni i ofruar përmes këtij udhëzuesi ka të bëjë me funksionimin e rrjeteve profesionale dhe në mënyrë më specifike të rrjeteve të mësuesve ndihmës. Këto udhëzime i vijnë në ndihmë specialistëve në ZVA përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e punës së rrjeteve profesionale; drejtuesve të rrjeteve profesionale përgjegjës për organizmin dhe koordinimin e punës së një rrjeti si dhe të gjithë mësuesve ndihmës, anëtarë të rrjeteve profesionale, të cilët duhet të jenë pjesëtarë aktiv të rrjetit dhe të shfrytëzojnë efektivisht të gjithë shkëmbimet në rrjet për të përmirësuar aftësitë e tyre profesionale.

Përgatitja e udhëzuesit u mundësua nga specialistë të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Kualifikimit në ASCAP, në mbështetje Udhëzimit nr.1, datë 20.01.2017, të MASR, “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” si dhe Udhëzimit nr.26, datë 25.11.2019 “Për mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”



Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së  
Arsimit Parauniversitar

[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)



# Përmbledhje

Sipas Udhëzimit nr.1, datë 20.01.2017. “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, një nga format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë janë rrjetet profesionale. Rrjetet profesionale kanë për qëllim zhvillimin profesional të punonjësve të institucioneve arsimore përmes:

- **Informimit dhe këshillimit** në lidhje me risitë dhe zhvillimet në fushën e reformave në arsimin parauniversitar;
- **Trajnimit** të e pjesëtarëve të rrjetit në lidhje me tematika që dalin si nevoja të tyre;
- **Shkëmbimit të eksperiencave** pozitive dhe të suksesshme mes pjesëmarrësve në rrjet për tematika të punës së tyre të përditshme;
- **Shkëmbimit në internet** të përvojave, mendimeve, pyetjeve dhe përgjigjeve që mbështesin zhvillimin profesional.

# Çfarë janë rrjetet profesionale?

Rrjetet profesionale janë nga format më efektive të zhvillimit profesional në nivel lokal. Punonjësit arsimore, pjesë e një rrjeti, kanë përfitime në aspektin e rritjes dhe zhvillimit profesional. Ata, të përfshirë në një rrjet profesional: rriten profesionalisht; mësojnë nga të njëri tjetri, si dhe kontribuojnë më shumë për komunitetin brenda institucionit dhe përtej tij.



- Rrjetet profesionale bashkojnë punonjës arsimorë me interesa të përbashkëta për lëndën që zhvillojnë, rolin/pozicionin që kanë në institucionin e tyre apo dhe fusha të tjera të rëndësishme për mbarëvajtjen e veprimtarive shkollore në funksion të përmirësimit të të nxënimit të nxënësve.
- Një rrjet bashkon punonjës arsimorë si: drejtues shkollash, mësues të ciklit fillor, mësues të së njëjtës lëndë në një nivel shkollimi, mësues të së njëjtës fushë të nxëni në një nivel shkollimi, mësues kujdestar, mësues koordinator të shkollave qendër komunitare, mësues që kujdesen për parandalimin e braktisjes shkollore, psikologë shkollore etj., etj.
- Llojet e rrjeteve profesionale në një ZVA përcaktohen në varësi të nevojave dhe prioriteteve lokale, përparësive arsimore në periudha të caktuara si dhe burimeve e kapaciteteve në nivel lokal.
- Anëtarët e rrjetit, që e kanë të mundur, formojnë gjithashtu, një rrjet në internet me anë të një platforme digjitale, nëpërmjet të cilit shkëmbejnë përvoja, parashtrojnë pyetje dhe marrin përgjigje nga kolegë.

# Ngritja e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës

- ZVA-ja organizon ngritjen e rrjeteve profesionale në zonën që ajo mbulon. Tematikat apo fushat, sipas të cilave ngrihen rrjetet profesionale, i përgjigjen përparësive që ZVA-ja ka përcaktuar nga identifikimi i nevojave në nivel lokal si dhe përparësive të shpalluara në nivel kombëtar. Një rrjet i tillë është edhe ai i mësuesve ndihmës, si një prioritet kombëtar në nxitjen dhe mbështetjen e arsimit gjithpërfshirës në vend.
- Në një rrjet profesional mund të marrin pjesë jo më shumë se 30 punonjës arsimorë. Në qoftë se për një fushë të caktuar në nivel lokal ka më shumë mësues, atëherë krijohet më shumë se një rrjet në atë fushë. P.sh, nëse mësuesit ndihmës në një ZVA të caktuar janë më shumë se 30 mësues, atëherë krijohen disa rrjete. ZVA-ja zgjedh t'i ndajë ato sipas cikleve ku janë angazhuar, sipas afërsisë së institucioneve arsimore ku bëjnë pjesë mësuesit ndihmës të një rrjeti, apo sipas ndonjë kriteri tjetër që i përgjigjet specifikave të një lokaliteti të caktuar. Kështu p.sh, në ato raste kur numri i mësuesve ndihmës në një ZVA është shumë i vogël mund të zgjidhet që të krijohet një rrjet i përbashkët me psikologët shkollor dhe/ose punonjësit social.
- Në rastet kur shkolla është me drejtim të orientuar ose profesionale, e vetme në një ZVA nuk mund të krijohet rrjet mësuesish për lëndët profesionale në nivel lokal, pasi është vetëm një shkollë në atë zonë dhe mësuesit janë vetëm të po asaj shkolle.
- Përzgjedhja e drejtuesit të rrjetit bëhet nga ZVA-ja bazuar në kriteret për drejtues rrjeti. Kjo përzgjedhje bëhet mes dy kandidaturave për drejtues rrjeti që anëtarët e rrjetit kanë propozuar pas takimit të tyre të parë.
- Drejtuesi i rrjetit është një nga punonjësit arsimor që i takon rrjetit. Ai duhet të ketë punuar të paktën 10 vjet si mësues. Parapëlqehen mësues që janë vlerësuar "Shkëlqyeshëm" ose "Shumë mirë" në provimin e fundit të tij të kualifikimit. Në rastin e rrjetit të mësuesve ndihmës, do të ishte më efektive nëse drejtuesi i rrjetit kishte kualifikime specifike në fushën e pedagogjisë së specializuar.
- Drejtuesi i rrjetit ka në dispozicion kohë nga norma e tij për t'iu kushtuar punës për mirëfunksionimin e rrjetit. Drejtuesit të rrjetit i ulet nga norma me 2 orë në javë. Kjo kohë përdoret për të përgatitjen e takimeve të rrjetit, për përgatitjen e seancave trajnuese me rrjetin si dhe për marrjen pjesë në trajnime.
- Drejtuesi i rrjetit zëvendësohet me kërkesën e anëtarëve të rrjetit ose nga sektori i programeve të zhvillimit në ZVA, në rast të mosplotësimit në mënyrë cilësore të detyrave të tij, të përcaktuara në këtë Udhëzim.
- Drejtuesi i rrjetit drejton dhe organizon veprimtaritë e rrjetit për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Nëse drejtuesi i rrjetit dorëhiqet ose nuk përmbush përgjegjësitë e ngarkuara, zëvendësohet nga ZVA-ja me një mësues tjetër, anëtarë të rrjetit.

# 4 Funksionimi i rrjetit profesional të mësuesve ndihmës



Anëtarët e rrjetit profesional të mësuesve ndihmës mund të takohen disa herë gjatë një viti shkollor, **POR jo më pak se një herë në muaj**. Shpeshësia e takimeve **përcaktohet nga ZVA-ja** në konsultim me anëtarët e rrjetit. Kjo varet nga tematikat e rrjetit si dhe nga nevoja e anëtarëve për t'u mbedhur. Rrjeti shfrytëzon jo vetëm takimet e drejtpërdrejta të anëtarëve, por edhe mundësitë online për të përcjellë e komunikuar në mënyrë të vazhdueshme. Në kushtet e pandemisë dhe të pezullimit të zhvillimit të mësimit në mjediset e institucioneve arsimore, rrjeti i mësuesve ndihmës duhet të vazhdojë të realizojë takimet dhe shkëmbimet mes tyre përmes formave online që rezultojnë më të përshtatshme dhe të aksesueshme për anëtarët e rrjetit.

**Takimet e rrjetit zhvillohen në mjediset e një institucioni arsimor** që ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e takimeve. Takimet mund

të zhvillohen edhe online nëpërmjet forumeve të posaçme. ZVA-ja dhe specialisti i caktuar për të monitoruar punën e rrjetit njoftohet dhe është në dijeni të vazhdueshëm për vendin dhe orën e takimeve për secilin rrjet.

Në çdo takim të rrjetit shtjellohet **një temë, e cila lidhet me praktikën e punës së përditshme**. Tematikat e zgjedhura janë:

- planifikuar në fillim të vitit shkollor nga drejtuesi i rrjetit në bashkëpunim me anëtarët e tij; dhe
- pjesë e prioriteteve apo risive të dala nga MASR, ASCAP apo ZVA-ja në një periudhë të caktuar të vitit.

Drejtuesi i rrjetit ka **dosjen ku dokumenton gjithë punën e rrjetit**. Për çdo takim të rrjetit përgatitet një raport i shkurtër, dokumentohen materialet e përdorura apo të prodhuara për takimet, dokumentohet prezenca e anëtarëve me anë të listprezencave. Drejtuesi i rrjetit siguron që të ketë një evidencë (fletore regjistër) me frekuentimin e takimeve nga anëtarët e rrjetit. Nëse ka anëtarë që nuk marrin pjesë në takime, duhet bërë me dije specialisti i ZVA-së që mbulon rrjetin e mësuesve ndihmës.

Drejtuesi dhe anëtarët e rrjetit **shfrytëzojnë materiale burimore** të ofruara nga MASR, ASCAP, QSHA apo ndonjë institucion tjetër që kontribuon në fushën e arsimit parauniversitar dhe veçanërisht në fushën e arsimit gjithëpërfshirës si dhe punës në klasë dhe shkollë me fëmijët me nevoja të veçanta. Vetë anëtarët e rrjetit mund të kontribuojnë me materiale të prodhuara prej tyre dhe që gjejnë zbatim në procesin e mbështetjes së arritjeve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollë.

# Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të rrjetit profesional të mësuesve ndihmës

Drejtuesi i rrjetit të mësuesve ndihmës angazhohet dhe merr përgjegjësi të plota për mirëfunksionimin e rrjetit. Ai dallohet për:

- ide novatore dhe për aftësi krijuese profesionale;
- aftësi drejtuese dhe menaxhuese të seancave/takimeve informuese, këshilluese apo trajnuese me anëtarët e rrjetit;
- qëndrimin etik dhe aftësi komunikuese me kolegë;
- korrektesë në kryerjen e detyrave si anëtar i personelit të institucionit arsimor;
- gatishmërinë për të bashkëpunuar me kolegë;
- aftësi profesionale të transmetimit të saktë dhe të qartë të informacionit shkencor dhe didaktik te kolegët.



Drejtuesi i rrjetit **njeh mirë legjislacionin** që ka të bëjë jo vetëm drejtpërdrejtë me veprimtarinë e rrjetit por edhe me zhvillimin profesional të punonjësve arsimor në sistemin arsimor parauniversitar. Ai qëndron në kontakt të vazhdueshëm me materialet, udhëzuesit dhe produktet që MASR dhe ASCAP ofron në dobi të funksionimit të rrjeteve të mësuesve ndihmës.

Drejtuesi i rrjetit, në bashkëpunim me specialistin përkatës të ZVA-së, harton dhe dokumenton listën e mësuesve ndihmës që bëjnë pjesë në rrjetin që drejton. Sugjerohet që për **anëtarët e rrjetit krijohet një databazë me të dhëna për karrierën profesionale të tyre si:** eksperiencia në punë, kualifikime të marra, trajnime dhe programe trajnimi të ndjekura, kredite të fituara, etj.

# Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të rrjetit profesional të mësuesve ndihmës

Drejtuesi i rrjetit ka **përgjegjësi** dhe detyrë:

- zhvillimin cilësor të takimeve të rrjetit, nëpërmjet organizimit të përgatitjes paraprake të anëtarëve të rrjetit;
- organizon dhe drejton takimet e rrjetit me një tematikë të caktuar;
- realizon takime të rrjetit dhe përcjell informacionet që merr nga institucionet e tjera si ZVA-ja, ASCAP, QSHA-ja etj;
- plotëson listën e pjesëmarrësve me nënshkrimin e çdo pjesëmarrësi dhe e dorëzon te specialisti përkatës i ZVA-së;
- përgatit një raport të shkurtër për çdo takim të rrjetit, si dhe raport vjetor për veprimtaritë e rrjetit të mësuesve ndihmës (formati në shtojcë).



Drejtuesi i rrjetit **harton planin vjetor të veprimtarive** të rrjetit. Plani hartohet në bashkëpunim me anëtarët e rrjetit. Plani përmban: tematikën për çdo rubrikë, rezultatet e pritshme për tematikën, veprimtaritë që do të zhvillohen për të realizuar këtë tematikë, personat përgjegjës, afatin kohor të zhvillimit të takimit si dhe rubrika të tjera që drejtuesi i gjykon të arsyeshme (formati në shtojcë).

Drejtuesi i rrjetit luan edhe rolin e **trajnerit për tematika të ndryshme** në rrjetin që ai drejton. Ai shfrytëzon të gjitha mundësitë për të qenë i aftë si trajner për anëtarët e rrjetit të mësuesve ndihmës, ndjek të gjitha takimet apo trajnimet që zhvillohen në shërbim të përsosjes së aftësive të tij profesionale si dhe përcjell me profesionalizëm materialet burimore dhe informacionet e ofruara për mësuesit ndihmës.



# Detyrat dhe përgjegjësitë e ZVA-së

ZVA-të përgatisin punën për ngritjen e rrjeteve të mësuesve ndihmës dhe organizojnë ato sipas përparësive të identifikuara. Në çdo ZVA titullari ngarkon specialistë të zyrës me përgjegjësinë për të **organizuar, monitoruar dhe vlerësuar** rrjetin e mësuesve ndihmës. **Një specialist mund të ndjekë dhe monitorojë funksionimin e disa rrjeteve njëherësh.**

ZVA-të me specialistët e ngarkuar kanë përgjegjësinë dhe detyrën e monitorimit dhe vlerësimit të zhvillimit të takimeve dhe cilësinë e zhvillimit të tyre. Ata zotërojnë listën e anëtarëve të secilit rrjet dhe të dhënat e tyre të përgatitura në bashkëpunim me drejtuesin e rrjetit.

Specialistët e rrjeteve monitorojnë dhe vlerësojnë punën e rrjetit bazuar në **formatin e vlerësimit të ofruar nga ASCAP (formati në shtojcë).** Formatin e vlerësimit mund të pasurohet dhe ndryshohet në varësi të specifikave të rrjetit apo kushteve të tjera.

Specialisti i ZVA-së kryen monitorimin dhe vlerësimin e rrjetit të paktën një herë në tre takime.

Specialisti i ZVA-së i paraqet përgjegjësit të sektorit të programeve të zhvillimit të burimeve njerëzore ose përgjegjësit të sektorit të kurrikulës në ZVA listën e punonjësve arsimorë të rrjeteve që ai mbulon si dhe raportet e vlerësimit për rrjetet e monitoruara.

Specialistët organizojnë takime me drejtuesit e rrjeteve që mbulojnë për të shkëmbyer mendime për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë së rrjeteve. Këto takime zhvillohen **një herë në tre muaj.**

S H T O J C Ë

PLANI VJETOR I DREJTUESIT TË RRJETIT TË MËSUESVE NDIHMËS

**SHEMBULL**

ZVA \_\_\_\_\_

EMËRTIMI I RRJETIT \_\_\_\_\_

DREJTUESI I RRJETIT \_\_\_\_\_

| Tematikat e takimeve të rrjetit                    | Rezultatet e pritshme   | Veprimtaritë   | Personi përgjegjës për realizimin e veprimtarisë          | Afati kohor i zhvillimit të veprimtarisë |
|--|---|--|---|--|
| <b>Hartimi i planeve edukativë individual, PEI</b> | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësuesit diskutojnë mbi planet edukative individuale, zbatimi i rubrikave të tyre.</li> <li>➤ Mësuesit analizojnë planin PEI të hartuar etj.</li> <li>➤ Mësuesit demonstrojnë planin PEI duke shkëmbyer eksperiencat dhe përvojat e tyre.</li> </ul> | Mbledhja e materialeve për takimin                                 | Drejtuesi i rrjetit                                       | Tetor 2020                               |
|  |   | Diskutimi me mësuesit që do të prezantojnë modele të planeve PEI   | Anëtari i rrjetit që do prezantojë                        | .....                                    |
|  |   | Diskutimi me mësuesit që do të prezantojnë modele të planeve PEI   | Drejtuesi i rrjetit<br>Anëtari i rrjetit që do prezantojë | .....                                    |
|  |   | Përgatitja e materialeve për takimin e rrjetit                     | Drejtuesi i rrjetit                                       | .....                                    |
|  |   | Organizimi i takimit të rrjetit në kohën dhe vendin e paracaktuar. | Drejtuesi i rrjetit<br>Specialisti i ZVA-së               | .....                                    |
|  |   | Hartimi i raportit për ecurinë e takimit.                          | Drejtuesi i rrjetit                                       |  |
|  |   |  |   |  |
| <b>Bashkëpunimi me mësuesin e klasës ...</b>       | .....   | .....  | .....   | Nëntor 2020                              |
|  | .....   | .....  | .....   | .....                                    |
|  | .....   | .....  | .....   | .....                                    |
| .....  | .....   | .....  | .....   | Dhjetor 2020                             |
|  |   | .....  | .....   | .....                                    |
|  |   | .....  | .....   | .....                                    |

## RAPORT I SHKURTER I TAKIMIT TË RRJETIT

| ZVA |
|-----|
|     |

| Data e takimit |
|----------------|
|                |

| Tema e takimit |
|----------------|
|                |

| Drejtuesi i rrjetit |
|---------------------|
|                     |

| Rrjeti |
|--------|
|        |

| Nr. i anëtarëve<br>në rrjet | Nr. i anëtarëve<br>prezent |
|-----------------------------|----------------------------|
|                             |                            |

| Rezultate të pritshme | Çështje të diskutuara në takim |
|-----------------------|--------------------------------|
|                       |                                |

| Materiale burimore të përdorura për takimin | Sugjerime dhe rekomandime |
|---|---------------------------|
|   |                           |

Drejtuesi i Rrjetit Profesional

Emri mbiemri \_\_\_\_\_

Firma \_\_\_\_\_

## VLERËSIMI I TAKIMIT TË RRJETIT NGA SPECIALISTI I ZVA-së

| ZVA |
|-----|
|     |

| Data e takimit |
|----------------|
|                |

| Tema e takimit |
|----------------|
|                |

| Drejtuesi i rrjetit |
|---------------------|
|                     |

| Rrjeti |
|--------|
|        |

| Nr. i anëtarëve në rrjet | Nr. i anëtarëve prezent |
|--------------------------|-------------------------|
|                          |                         |

| Treguesi   | Vlerësimi         |               |                 |           |
|--|-------------------|---------------|-----------------|-----------|
| A zhvillohet takimi sipas <b>orës së paracaktuar</b> ?   | Po (1)            | Jo (0)        |                 |           |
| Pjesëmarrësit në takim kanë ardhur <b>të përgatitur</b> .  | Shumë mirë (3)    | Mirë (2)      | Mjaftueshëm (1) | Dobët (0) |
| Pjesëmarrësit tregojnë përvojat e tyre <b>interesante</b> .  | Shumë mirë (2)    | Disi (1)      | Aspak (0)       |           |
| Pjesëmarrësit në takim <b>drejtojnë pyetje njëri-tjetrit</b> .   | Shpesh (2)        | Rrallë (1)    | Asnjherë (0)    |           |
| Pjesëmarrësit në takim <b>debatojnë</b> duke nxitur risi dhe duke dhënë zgjidhje                                 | Herë pas here (2) | Rrallë (1)    | Asnjëherë (0)   |           |
| Pjesëmarrësit janë <b>të vemendshëm</b> ndaj mendimeve dhe përvojave të kolegëve.                                | Përherë (2)       | Kryesisht (1) | Rrallë (0)      |           |
| Drejtuesi <b>nxit</b> shkëmbimin e mendimeve dhe përvojave për praktikën e punës së përditshme të pjesëmarrësve. | Shumë mirë (3)    | Mirë (2)      | Mjaftueshëm (1) | Dobët (0) |
| Drejtuesi <b>flet vetë më shumë</b> .  | Po (0)            | Jo (1)        |                 |           |
| Diskutimet bëhen të qeta, dhe drejtuesi <b>menaxhon diskutimet</b> .   | Po (1)            | Jo (0)        |                 |           |
| <b>Shuma e pikëve</b>  |                   |               |                 |           |
| <b>Shuma e përgjithshme</b>  |                   |               |                 |           |

Pikat e forta të vëzhguara \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Sugjerime për përmirësim: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Vëzhguesi/Monitoruesi**

**Emri mbiemri** \_\_\_\_\_

**Firma** \_\_\_\_\_

## UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E TABELËS

Për çdo rresht, vëzhguesi vendos X ose ✓ numrin që ai e gjykon se i takon si masë e vlerësimit. P.sh. te rreshti “Pjesëmarrësit tregojnë përvojat e tyre **interesante**”, objekti i vëzhguesit është fjala “**interesante**”. Kur vëzhguesi çmon shumë interesante përvojat e treguara nga pjesëmarrësit, vendos një kryq te numri “2”.

Po qe se vëzhguesi vë re se drejtuesi **flet vetë tepër** dhe nuk i le të tjerët të japin mendimet e tyre, atëherë vendos kryqin te numri “0”.

Më pas gjendet shuma e numrave për çdo shtyllë dhe **shuma e përgjithshme**.

**P.sh.**

| Treguesi   | Vlerësimi                  |                   |                 |           |
|--|----------------------------|-------------------|-----------------|-----------|
| A zhvillohet takimi sipas <b>orës së paracaktuar</b> ?   | Po (1) <b>X</b>            | Jo (0)            |                 |           |
| Pjesëmarrësit në takim kanë ardhur <b>të përgatitur</b> .  | Shumë mirë (3)             | Mirë (2) <b>X</b> | Mjaftueshëm (1) | Dobët (0) |
| Pjesëmarrësit tregojnë përvojat e tyre <b>interesante</b> .  | Shumë mirë (2)             | Disi (1) <b>X</b> | Aspak (0)       |           |
| Pjesëmarrësit në takim i <b>drejtojnë pyetje njëri-tjetrit</b> .   | Shpesh (2) <b>X</b>        | Rrallë (1)        | Asnjherë (0)    |           |
| Pjesëmarrësit në takim <b>debatojnë</b> duke nxitur risi dhe duke dhënë zgjidhje                                   | Herë pas here (2) <b>X</b> | Rrallë (1)        | Asnjëherë (0)   |           |
| Pjesëmarrësit janë <b>të vemendshëm</b> ndaj mendimeve dhe përvojave të kolegëve.                                  | Përherë (2) <b>X</b>       | Kryesisht (1)     | Rrallë (0)      |           |
| Drejtuesi <b>nxit</b> shkëmbimin e mendimeve dhe përvojave për praktikatat e punës së përditshme të pjesëmarrësve. | Shumë mirë (3)             | Mirë (2) <b>X</b> | Mjaftueshëm (1) | Dobët (0) |
| Drejtuesi <b>flet vetë më shumë</b> .  | Po (0)                     | Jo (1) <b>X</b>   |                 |           |
| Diskutimet bëhen të qeta, dhe drejtuesi <b>menaxhon diskutimet</b> .   | Po (1) <b>X</b>            | Jo (0)            |                 |           |
| <b>Shuma e pikëve</b>  | <b>8 pikë</b>              | <b>6 pikë</b>     |                 |           |
| <b>Shuma e përgjithshme</b>  | <b>14 pikë</b>             |                   |                 |           |

**P.S SUGJEROHET** ZVA mund të përcaktojë një ndarje të pikëve për të vlerësuar ecurinë e rrjetit.

| Shumë mirë | Mirë  | Mjaftueshëm | Dobët |
|------------|-------|-------------|-------|
| 15-17      | 12-14 | 9-11        | 0-8   |